



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:151950
Datë: 07.05.2024
Numri i dokumentit: 05658472

A.C.nr.2292/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, me Gjyqtarin individual Bujar Muzaqi, në çështjen përmbareme të kreditorit Kolegji “I...”, me seli në Rruga “G.Z.” nr..., Komuna Prishtinë, kundër debitorit M.M. me vendbanim në Komuna Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson T.Xh., avokate me seli në Komuna Prishtinë, lidhur me çështjen përmbareme për borxh, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore Prishtinë, departamenti i përgjithshëm, PPP.nr.2688/20 datë 29.09.2021, me datë 30.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e debitorit M.M. me vendbanim në Komuna Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, departamenti i përgjithshëm, PPP.nr.2688/20 datë 29.09.2021, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, departamenti i përgjithshëm, me aktvendimin e atakuar PPP.nr.2688/20 datë 29.09.2021, ndër të tjera ka vendosur si vijon:

“...PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit M.M. nga Prishtina, SHFUQIZOHET Urdhri për lejimin e Përmbaremit P. nr.1841/20 i datës 07.10.2020, i lejuar nga Zyra Përmbareme V.L. me Përmbareuesin Privat I.G...”

Kundër aktvendimit PPP.nr.2688/20 datë 29.09.2021, në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori, për shkak të shkeljeve esenciale të LPP dhe LPK-së, me propozim që të aprovohet ankesa e debitorit si e bazuar dhe të detyrohet kreditorit ti paguaj shpenzimet e procedurës.

Përgjigje në ankesë nuk është paraqitur.

Gjyqtari individual i Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbaremore, si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore, gjeti se:

-Ankesa është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës konstatohet se kreditori "Kolegji "I...", me seli në Rruga "G.Z.", nr.75, Komuna Prishtinë, me datë 24.09.2020, ka paraqitur propozim për përmbaremore kundër debitorit M.M. me vendbanim në Komuna Prishtinë, për pagesën e borxhit në bazë të faturës.

Përmbaremoresi privat e ka lejuar përmbaremoren me Urdhër për lejimin e përmbaremore P.nr.1841/20, të datës 25.05.2020, ndaj të cilit Urdhër debitori ka paraqitur prapësim me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin për përmbaremore meqenëse nuk i plotëson kushtet e parapara sipas nenit 22 të LPP-së. Përgjigje në prapësim ka paraqitur kreditorit me propozim që të refuzohet prapësimi i debitorit dhe të vërtetohet urdhri i përmbaremoresit privat.

Gjykata Themelore në Prishtinë, departamenti i përgjithshëm, me aktvendimin e atakuar PPP.nr.2688/20 datë 29.09.2021, e ka pranuar prapësimin e debitorit, dhe e ka shfuqizuar urdhrin për lejimin e përmbaremore, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Në arsyetimin e aktvendimit të atakuar ndër të tjera thuhet se: "... Gjykata, në një gjendje faktike të konstatuar si më lartë, dhe në kuptim të dispozitave të lartëcekura, erdhi në përfundimin se përmbaremore në këtë çështje përmbaremore është caktuar pa u plotësuar kushtet ligjore për nxjerrjen e urdhërit përmbaremore të parapara me dispozitat e sipër cituara të LPP-së, për faktin se dokumenti i besueshëm-faturat mbi bazën e të cilave është ushtruar propozimi për përmbaremore, është i papërshtatshëm për përmbaremore, sepse nuk është pranuar dhe nënshkruar nga debitori i përmbaremore për pasur këtë cilësi në këtë procedurë mirëpo, kreditorit i përmbaremore në pajtim me dispozita ligjore në fuqi, mundet që për kërkesën e tij, të kërkoj mbrojtje gjyqësore në kontest të rregullt civil pranë gjykatës kompetente. Andaj, gjykata në rastin konkret përcakton se nuk janë plotësuar kushtet ligjore, për nxjerrjen e urdhrit për përmbaremore nga përmbaremoresi privat, në kuptim të nenit 43 paragrafi 4 i LPP - së, sepse është lejuar përmbaremore në bazë të një dokumenti të pa pranuar dhe nënshkruar nga ana e debitorit, rrjedhimisht, në kuptim

të Nenit 29.3 në lidhje me Nenin 43.4 dhe 71, paragrafi 1.1 të LPP-së, Gjykata vlerësoj Prapësimin e debitorit si të bazuar...”.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejt dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, i njëjti është i kuptueshëm dhe i kuartë, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e Apelit, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (b), (g), (j) (k) dhe (m) të LPK, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore.

Në nenin 71 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore përcaktohen shkaqet e prapësimin, ku në pikën 1 të këtij neni në mënyrë decisive thuhet se “...Dokumenti, në bazë të cilit është marr vendimi përmbartues ose urdhri përmbartues, nuk ka titull ekzekutiv ose nuk ka tipare të përmbartueshmërisë”, ndërsa në nenin 73 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore ndër të tjera thuhet se “ me vendim prapsimi mund të pranohet”, andaj bazuar në këtë e po ashtu edhe në prapësimin e debitorit ku janë të cekura shkaqet ligjore të cilat pengojnë përmbartimin e këtij dokumenti – Faturës, gjykata e shkallës së parë ka vendosur sikurse në dispozitivin e Aktvendimit të atakuar.

Në faturën nr.unik 810527103 datë 12.02.2020, të marra nga ana e Kreditorit në pjesën e pagesës ndër të tjera thuhet se “...shërbime të kryera gjatë studimeve bachelor...”, ndërsa kreditori nuk ka paraqitë asnjë dëshmi në Gjykatë se debitori i ka pranuar këto fatura nga ana e Kreditorit.

Ndërsa në nenin 30 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore në mënyrë decisive thuhet se “Kur nga dokumenti i besueshëm nuk shihet se a është bërë e kërkueshme kredia, atëherë përmbartimi caktohet vetëm në qoftë se kreditori paraqet deklaratë me shkrim se kredia e tij është bërë e kërkueshme duke u treguar edhe dita për një gjë të tillë”.

Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet ankimore të kreditorit se kemi të bëjmë me konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar i të drejtës materiale, janë pretendime të pabazuara dhe të njëjtat nuk përbëjnë bazë për anulimin e aktvendimit të atakuar, pala kreditore me ankesën e paraqitur nuk ka ofruar asnjë arsye për të mbështetur pretendimet e saj ankimore se kemi zbatim të gabuar të së drejtës materiale, ndërsa Gjykata gjithashtu duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare konstaton se aktvendimi i atakuar është i drejtë dhe i ligjshëm, dhe i mbështetur në dispozita ligjore.

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore të kreditorit, por Gjykata e Apelit nuk ka gjetur se aktvendimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual në shkallë të dytë, bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të Ligjit nr.04/L-139 për procedurën përmbarimore, në të cilin nen ndër të tjera thuhet se *“Në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual”*.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208, 209 paragrafi pika b) të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore, e lidhur me nenin 17 të Ligjit nr.04/L-139 për procedurën përmbarimore, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
A.C.nr.2292/2022 datë 30.04.2024

Gjyqtari,
Bujar Muzaqi